

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;  
Kuvendi i Komunës së Junikut;  
Numër: 02-180/01/21;  
Datë: 22.01.2021 .

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.9.2010) dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut iu bënë këtë:

**FTESË**

**Për:** anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut;  
**Nga:** Muharrem Krasniqi – kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut;  
**Lënda:** mbledhja e parë-(2021) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Junikut;  
**Vendi:** salla e Kuvendit të Komunës së Junikut;  
**Data:** 29.01.2021, ora 14<sup>00</sup>.



**Rendi i ditës:**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Kërkesë për ndarjen e mjeteve për banoret e Komunës së Junikut të cilët janë të infektuar me Covit 19, si dhe familjet e atyre të cilët humbën betejën me Covit 19,
3. Proxim vendimi për planin për zhvillim ekonomik lokal 2020-2025 (leximi i dytë),
4. Të ndryshme ,



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPSTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK

|                       |                                                       |
|-----------------------|-------------------------------------------------------|
| REFERENC-Ë:           | Numër: 02– 12/20                                      |
| PËR/ZA/TO:            | Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik                     |
| NGA/OD/FROM           | Muharrem Krasniqi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik |
| DATË/A                | 29.12.2020                                            |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT | Procesverbal                                          |

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 18 paragrafi 1, i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK- Junik mbanë këtë:

### PROCESVERBAL

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së njëmbëdhjetë të rregullt të Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2020 me datë: 29.12.2020, në ora 14:00, në sallën e KK-Junik. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Muharrem Krasniqi, Kryesues i Kuvendit Komunal të Junikut, i cili fillimisht përshëndeti, Kryetarin e Komunës z. Agron Kuçi, Nënkryetarin z. Faik Tofaj, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Zyrtarët Komunal, Anëtarët e Kuvendit Komunal – Junik, dhe të pranishmit.

#### Anëtarët prezent

- |                                     |                                      |
|-------------------------------------|--------------------------------------|
| 1. Muharrem Krasniqi -kryesues, AAK | 11. Zeqë Hebibi – anëtar, LDK        |
| 2. Behare Qestaj – anëtare, AAK     | 12. Erleta Isufaj – anëtare, LDK     |
| 3. Sindije Idrizi – anëtare, AAK    | 13. Zenel Maloku – anëtar, i pavarur |
| 4. Betim Gacaferi – anëtar, AAK     | 14. Blerim Gacaferi – anëtar, PDK    |
| 5. Albert Gjocaj – anëtar, AAK      | 15. Gjyle Miroci – anëtare, LVV      |
| 6. Xhemë Tofaj – anëtar, AAK        |                                      |
| 7. Dardane Shala – anëtare, AAK     | Mungoi: Asnjë                        |
| 8. Tahir Isufaj – anëtar, LDK       |                                      |
| 9. Florim Shala, anëtar, LVV.       |                                      |
| 10. Edona Shehu – anëtare, LDK      |                                      |

### **Rendi i ditës:**

- 1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
- 2.Plotësim - ndryshimin e Rregullores komunale për caktimin e orarit të punës së subjekteve afariste në territorin e Komunës së Junikut,
- 3.Plotësim - ndryshimin e planit komunal për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Junikut,
- 4.Shqyrtimi dhe miratimi i projekt planit të punës të Kuvendit Komunal dhe planeve të komiteteve të përhershme për vitin 2021(leximi i dytë),
- 5.Shqyrtimi dhe miratimi i projekt rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës (leximi i parë),
- 6.Shqyrtimi dhe miratimi i orarit të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit Komunal në Komunën e Junikut për vitin 2021,
- 7.Shqyrtimi dhe miratimi i planit të Integritetit (leximi i dytë),
- 8.Kërkesë për ndërrimin e destinacionit të tokës Fatmir Maloku,
- 9.Të ndryshme.

**z.Muharrem Krasniqi:**E hapim diskutimin për sa i përket rendit të ditës.Fjala për përfaqësuesit e grupeve.

**znj.Behare Qestaj:**Faleminderit kryesues.Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ne si grup e përkrahim rendin e ditës.

**z.Tahir Isufaj:**Unë e përkrahi. Mirëpo ne jemi marrë vesh në mbledhjen e kalune edhe ka shku në votim me 15 vota që ato mjetet që i ka ndarë qeveria e Kosovës për Komuna.Në bazë të numrit të banorëve për shkak të pandemisë me vlerë 270.000 €.Ne u morëm vesh që një pjesë e atyre mjetëve duhet me ju dediku njerëzve që kanë pasë nevojë,që nuk i kanë kushtet e mira.Njerëzit që kanë pasë Covid edhe që kanë pasë një familje të tërë që mundësit finaciare nuk i kanë bile me ju dal në ndihmë me një përqindje.Ato janë të cekne aty kemi votu por asgjë nuk është marrë.

**z.Muharrem Krasniqi:**Kemi me ju dalë në ndihmë besoj se do të marrim informatë.Nëse dëshironi e bëjmë si pikë kërkesë e rendit të ditës në muajin Janar.Pasi ky muaj ka qenë shumë i ngarkunë me plane dhe rregullore.Dikush tjetër sa i përket rendit të ditës.

**z.Florim Shala:**Edhe unë e pata këtë pyetje si të profesorit.

**z.Muharrem Krasniqi:**Besoj se në të ndryshme do ta kemi një përgjigje.Po nëse neve nuk na duket e plotë do të kërkojmë që të kemi si pikë të veçantë në Janar.A e dëshiron dikush tjetër fjalën, nëse jo e hedhim në votim rendin e ditës.

**Prezent 15, Për 12 vota, Abstenim 3 vota, Kundër Asnjë, Kalon.**

### **Pika e parë e rendit të ditës**

- 1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

**z.Muharrem Krasniqi:** Kolegë të nderuar para juve e keni procesverbalin.Nëse keni ndonjë vërejtje që nuk ju ka shkru fjalë ose ju ka ndryshuar ajo qka keni thënë? Nëse jo, e hedhi në votim.Kush është që ky procesverbal të kalojë?

**Prezent 15, Për 15 vota, Abstenim Asnjë, Kundër Asnjë, Kalon.**

### **Pika e dytë e rendit të ditës**

2.Plotësim - ndryshimin e Rregullores komunale për caktimin e orarit të punës së subjekteve afariste në territorin e Komunës së Junikut,

**z.Muharrem Krasniqi:**Fjalë për z. Turim Ganiqaj.

**z.Turim Ganiqaj:**Faleminderit kryesues.

**z.Tahir Isufaj:**Ne në pikën tre nuk kemi material?

**z.Muharrem Krasniqi:**Pikën tre e ke marrë materialin, ne qka kemi qenë KPF nuk na kanë sjellë materialin se e kemi marrë.

**z.Turim Ganiqaj:**Përshëndetje për të gjithë, Komuna e Junikut që nga viti i kaluar muajin dhjetor e kemi në fuqi këtë rregullore.Tani jemi në fazë e ndryshim plotësimin të sajë ku pritët të ndryshohet neni i 12 i kësaj rregullore.Ku flitet për orarin e punës së gastronomisë, e kemi kërkesë edhe nga MAPL-ja.Këtë rregullore e kemi ndryshu edhe në muajin shkurt të këtijë viti me vendim. Tash duhet me e ndryshu rregulloren me rregullore ,plotësim ndryshim akti njëjtë me akt të njëjtë.Do të ndryshohet vetëm fillimi 12 pika C, ku thuhet se pushimin e përcaktojnë vetë subjektet.

**znj.Behare Qestaj:**Ne e përkrahim këtë plotësim ndryshim.

**z.Tahir Isufaj:**Unë drejtë me thënë javën e kalune nuk jam pajtu me Turimin,por kur kam shku te shtëpia e kam shiku më detajisht.Ka të drejtë shumë ai ,se nuk është si gastronomia që kanë vetëm ushqim edhe pije e si hotelet që kanë edhe bujtinë.Se nëse ka musafir ai nuk mundet të mbyllet.

**z.Muharrem Krasniqi:**Profesor ne këtë e kemi kalu vetëm për këtë ndryshim është fjala.Se ai ka shku në Prishtinë është pranë ajo.Vetëm ndryshimi ka me shku.Atë rregullore e kemi kalu para një viti.

**z.Tahir Isufaj:**E ky që ka hotel qka? Qysh shkon?

**z.Muharrem Krasniqi:**Ky mundet me ju drejtu Gjykatës nëse është i pa kënaqur me vendimin e Kuvendit.Se vendimi është marrë nga Kuvendi e kemi dërgu atë rregullore janë pajtu.E kanë kthyer menjëherë për procedur me e shtu vetëm këtë pikë.

**z.Florim Shala:**A mundem me e marrë një kopje qysh e ka Deçani edhe Gjakova me e bërë.

**z.Muharrem Krasniqi:**Është e kryne ajo rregullore.

**z.Florim Shala:**Është e kryne keq.

**z.Muharrem Krasniqi:**Po nëse është e kryne keq mundesh me ju drejtu Gjykatës dhe na kthen përgjigje nuk ka problem.

**z.Agron Kuçi:**Mbledhi nënshkrimet 1/3 të asambleistëve dhe e bën një propozim.Një pikë të veçantë të rregullores ti e bën një propozim.Ose e bën të shoqatës të biznesit ose shoqatës të gastronomëve e bëje një propozim.

**z.Turim Ganiqaj:**Hotelëve nuk ju ndalohet veprimtaria në shtatë ditë të javës d.m.th komplet muaji me shërbimet e fjetjes por ndalohet vetëm për klientat e jashtëm.Nëse ka musafir që janë ka fletë aty ata mundet me i shërby me staf të mbrendshëm.Po një ditë duhet me e pasë të mbyllur për klientat e jashtëm që vin, ky është ndryshim që po bëhet.

**z.Florim Shala:**Këtë ndryshim bëjeni si Deçani e Gjakova.

**z.Muharrem Krasniqi:**Bëjë një kërkesë në emër të bizneseve çka e keni me fjetje dhe 1/3 e asambleistëve nënshkrimet.E dërgon si pikë e rendit të ditës.

**Prezent 15, Për 10 vota, Abstenim 5 vota, Kundër Asnjë, Kalon.**

### **Pika e tretë e rendit të ditës**

3.Plotësim - ndryshimin e planit komunal për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Junikut,

**z.Turim Ganiqaj:**Këtë plan e kemi kalu ndërsa në muajin nëntor ka ardhur një shkresë nga ministria e ekonomisë dhe ambientit.Ku kërkohet në hyrje të vendimit komunal për këtë plan të shtohet ligji për mbeturina.Pra d.m.th është gabim teknik i zyrës të kuvendit është dashur me e shkru në vendim se ky plan bazohet edhe në ligjin për mbeturina.Plani nuk ka asnjë vërejtje ne kemi kontaktuar edhe me ministri edhe me zyrtarë të GIZ-it.Por vetëm vendimi ka me e u ndryshu d.m.th ka me u shtu vetëm në vendim të kuvendit me u cekë se ky plan bazohet në ligjin për mbeturina.Është neni 10 ku Komuna ka të drejtë me bër plane të tilla.

**znj.Behare Qestaj:**Pra d.m.th në planë asgjë nuk preket.

**z.Turim Ganiqaj:**Në planë asnjë shkronjë nuk preket vetëm në vendim, preambul shtohet ligji për mbeturina edhe neni 10 asnjë ndryshim tjetër.

**z.Tahir Isufaj:**E neni 10 çka përfshin?

**z.Turim Ganiqaj:**Përcaktohet që Komuna mundet me bër plane dhe rregullore për menaxhim të mbeturinave.

**z.Muharrem Krasniqi:**E hedhim në votim.

**Prezent 15, Për 13 vota, Abstenim 2 vota, Kundër Asnjë, Kalon.**

### **Pika e katërt e rendit të ditës**

4.Shqyrtimi dhe miratimi i projekt planit të punës të Kuvendit Komunal dhe planeve të komiteteve të përhershme për vitin 2021 (leximi i dytë),

**z.Muharrem Krasniqi:**Kolegë të nderuar ne e kemi pasë edhe në lexim të parë nuk ka kërku dikush ndonjë ndryshim.

**z.Tahir Isufaj:**Jo kemi kërku.

**z.Muharrem Krasniqi:**Për ato po për të kuvendit po flas.

**z.Tahir Isufaj:**Për punë të kuvendit është në regull.

**znj.Dardane Shala:**Përhëndetje për të gjithë,fillimisht kisha pasë qejfë me i ditë vërjetjet prej anëtarëve të caktun.

**z.Muharrem Krasniqi:**Ti kam dërgu unë në mesazh kanë pasë me e i nënvizu ato.

**znj.Dardane Shala:**Pa dyshim secilën çështje që ne e diskutojmë është një drejtori përkatëse e cila është kompetente për atë çështje.Edhe ne si komitet jemi mundu që mbrenda atijë komiteti me i diskutu temat që na prekin neve në shoqëri dhe qytetarëve të Junikut.Drejtorja më bashkëpunuese gjatë kësaj periudhe është drejtorja e Arsimit edhe jam shumë mirënjohëse.Sa i përket vërejtjeve anëtarët që i kemi në komitet edhe ata kanë thënë se drejtorin e Arsimit e kemi ngarku.Dhe janë dikund pesë pika.Normal se plani varësisht prej nevojave dhe kalimin e kohës ka me pasë ndryshime dhe përmirësime kemi me i shtu edhe pika në rend të ditës.

**znj.Behare Qestaj:**Ne nuk kemi vërejtje, unë e kam pas planin me persona me aftësi të kufizune.

**z.Tahir Isufaj:**Po unë i kam bër vërejtjet edhe në komitet dhe financa.Duhet me e kuptu se Dardana nuk ka aspak faj në këtë punë dhe nuk ka përvojë.Unë nuk e di kush merret me materiale pak më shumë.Muaji mars p;sh thotë raporti nxënës profesor në shkollën fillore dhe të mesme në Komunën e Junikut.Mirëmbajtja e institucioneve publike dhe private gjatë virusit Covid 19, atëherë drejtorja e arsimit çka është këtu.Prilli pika 2-3 prap ecuria e zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme në shkollë në Komunën e Junikut,përfundimi i periodës së dytë në shkollën e Komunës së Junikut realizimi dhe rezultatet ku është drejtorja e arsimit.Dyshi informatë lidhur me shërbimet e pacientëve që afrohen nga ana e QKM-së në Junik.Informatë lidhur me qarkoren buxhetore 2021-2023 prej ministrisë së financave d.m.th tash po e mbulojmë edhe QKM-fën. Qeshor 2 informatë rreth infrastrukturës kulturore dhe arsimore në Komunën e Junikut.Kujt me ja dhënë këtë informatë prej komitetit.Komiteti është më i madh se ekzekutivi d.m.th po i përzë krejt drejtorit duhet me ja u lënë punët drejtorive.Korriku informatë rreth suksesit të nxënësve dhe realizimi i plan programeve me rastin e përfundimit shkollor 2020-2021.Shtatori gjendja e deponive të mbeturinave në Komunën e Junikut.

**znj.Dardane Shala:**Sa i përket këtyre pikave une ju tregova se për secilën pikë është një drejtori përkatëse,gjdo drejtori na ka dhënë informata edhe neve na kanë interesu.Ne jemi kompetent me i ngritë si çështje me i diskutu dhe me dhënë ju këshilla secilës drejtori që merr pjesë në atë mbledhje.Normal që ne nuk e kemi një rol vendim marrës ose material me i ekzekutu ato.Ne i

bëjmë rekomandimet nëse ata dëshirojnë me ndryshu për të mirë. Se ne nëse e kemi qitë një pikë të caktune kemi pasë diçka me diskutu për atë pikë p;sh për shkollë kemi dashtë me ditë si po ecë mësimi online.

**z.Muharrem Krasniqi:**A e dëshiron dikush fjalën nëse jo e hedhim në votim.

**Prezent 15, Për 9 vota, Abstenim 4 vota, Kundër 2 vota, Kalon.**

**z.Muharrem Krasniqi:**Te komiteti për aftësi të veçanta atë e kemi zavendësu.Pika e dytë ka qenë aktivitetet.Këtë javë ka qenë shërbimi i lajmërimit të pensionistëve të bëhet në Komunën e Junikut është hejë ajo të lajmërohet një herë në javë.

### **Pika e pestë e rendit të ditës**

5.Shqyrtimi dhe miratimi i projekt rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës (leximi i parë),

**z.Fatos Shala:**Faleminderit kryesues.

**z.Tahir Isufaj:**Nuk e pasna pa hiq sot u dashtë me e dhënë edhe ky një mendim.

**z.Fatos Shala:**Për arsim a?

**z.Tahir Isufaj:**Po sipas kësaj ti nuk ke nevojë me qenë aty.

**z.Fatos Shala:**Nuk ka problem unë i kam thënë Dardanes po na nxjerr pak telashe po nuk ka problem.

**z.Tahir Isufaj:**Komiteti për komitete është organ i kuvendit komunal.Kuvendi komunal është më i larti.

**znj.Dardane Shala:**E informatat prej cilës drejtori me i mar ne për me bër rekomandime.

**z.Tahir Isufaj:**E cilës drejtori po ja bën ti rekomandimet?

**znj.Dardane Shala:**Unë rekomandimet ja bëj drejtoris përkatëse.

**z.Fatos Shala:**Rregullorja për përkujdesje dhe mbrojtjen e fëmijëve kemi bër kërkesën që të jetë pastaj në lexim të parë.Komisioni ka qenë i themelunë me dy antarë të kuvendit Florimi ndërsa prej e administratës ka qenë Artani,Venera dhe Valbona.Ata dje janë taku Florimi nuk ka qenë nuk i di arsyet.Sot Artani është në mesin e juve që të ju informoj më shumë në KPF ka kalu kjo.

**znj.Behare Qestaj:**Nuk kemi vërejtje ne e përkrahim si grup.

**z.Florim Shala:**Drejtori me ka thirr në ora 13:45 më ka thënë hajde në ora 14:00, unë nuk munda me mbërri deri në ora 14:00 se isha në Deçan.

**z.Muharrem Krasniqi:**Jo unë deshta me ja u japë edhe një vërejtje se paraprakisht lihet edhe një raport i punës.Por është leximi i parë dhe po bëjmë lëshime.Sepse duhet të jetë raporti i komisionit çka kanë punu,çka ka ndryshu dhe vërejtjet e sygjerimet.Tjetër herë me e thirrë me kohë.

**z.Muharrem Krasniqi:**A e dëshiron dikush fjalën nëse jo e hedhim në votim.

**Prezent 15, Për 14 vota, Abstenim 1 votë, Kundër Asnjë, Kalon.**

### **Pika e gjashtë e rendit të ditës**

6.Shqyrtimi dhe miratimi i orarit të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit Komunal në Komunën e Junikut për vitin 2021,

**z.Muharrem Krasniqi:**Kolegë të nderuar unë kam e pasë vetëm një vërejtje ju kam dërgu me shkrim edhe drejtorave.Nëse kanë nevojë për ndryshim të orarit,ja u kam dërgu edhe juve me e pasë materialin.E kam pasë një vërejtje nga drejtoresha e financave ka kërku që mbledhja me 30.06.2021 mos të mbahet se ka me e dërgu në prishinë mbrenda muajit.Ne do ta mbajmë me 28.06.2021 i bjen ditë e hënë.

**z.Zenel Maloku:**Unë kom pas kërku dhe kemi bër debat se mbledhejt e kuvendit me u mbajtë në ora 10:00 e jo në ora 14:00.Se kemi pengesa ka njerëz që punojnë deri 14:00 edhe në ora 14:00 me ja fillu punës e duhet me mungu për të.

**z.Muharrem Krasniqi:**Është e rregullune me ligj ai njeri që vjen në kuvend i lejohet, nuk mundet me ja u ndalu privati e as e shtetit.

**z.Muharrem Krasniqi:**E hedhi në votim.

**Prezent 15, Për 15 vota, Abstenim Asnjë, Kundër Asnjë, Kalon.**

### **Pika e shtatë e rendit të ditës**

7.Shqyrtimi dhe miratimi i planit të Integritetit (leximi i dytë),

**znj.Leonita Jasiqi:**Përshëndetje për të gjithë, meqenëse plani si i tillë i ka kalu gjitha procedurat e duhura unë nuk kisha diskutu sot më shumë.Vetëm kisha kërku miratimin nga ana e juaj.

**z.Muharrem Krasniqi:**Këtu e keni raportin nga komisioni.

**znj.Behare Qestaj:**Nuk kemi vërejtje kryesues e përkrahim.

**z.Tahir Isufaj:**Në rregull është.

**z.Muharrem Krasniqi:**E hedhi në votim.

**Prezent 15, Për 15 vota, Abstenim Asnjë, Kundër Asnjë, Kalon.**

### **Pika e tetë e rendit të ditës**

8.Kërkesë për ndërrimin e destinacionit të tokës Fatmir Maloku,

**z.Muharrem Krasniqi:**Nga drejtoria përkatëse shpresoj se kur e kanë marrë këtë pikë të rendit të ditës e kam lexu udhëzimin administrativ.Shpresoj që keni marrë një varg veprimesh që duhet me i marrë.Kërkesës së tij çka duhet me i bashkangjit,a ka plan rregullativ,plan urbanistik dhe a ka kanlizimin ku e qet.

**z.Arian Xhuli:**Drejtoria për urbanizem është duke i zhvillu procedurat për hartimin e planit ajo është paraparë si zonë ndërtimore.Zona ku ka bërë zotria kërkesën për tokë bujqësore me e kthy zonë ndërtimore, gjdo gjë është sipas planit.

**z.Tahir Isufaj:**Ne nuk kemi asgjë kërkesën po, unë kur ti shoh letrat atëhere?

**z.Zeqë Hebibi:**Krejt në rregull ne e pamë çka ka me ndërtu po me ligj a po i plotëson krejt kushtet.Sjellnani neve a është krejt në rregull po jo qysh po thu ti me e votu.

**z.Muharrem Krasniqi:**Nëse ti e bën kërkesën në drejtori,drejtorja ka me i mbikqyr ato sene.Pastaj e bën kërkesën te kryetari përmes kryetarit te ne. Ne me e ngarku ose jo.Neve ka me na ardhë fleta poseduese e tij dhe plani qka ka me ndërtu ai.

**znj.Behare Qestaj:**Kryesues d.m.th dokumentat çka i takon asamblesë janë të gjitha.

**z.Muharrem Krasniqi:**Po.

**znj.Behare Qestaj:** Ne si grup e përkrahim.

**z.Muharrem Krasniqi:**E hedhi në votim.

**Prezent 15, Për 11 vota, Abstenim 4 vota, Kundër Asnjë, Kalon.**

### **Pika e nëntë e rendit të ditës**

9.Të ndryshme.

**znj.Erleta Isufaj:**Unë e kam një kërkesë për me e siguru një listë prej Komunës për krejt pronat shoqërore që janë në pronësi të Komunës.Edhe që ju kanë japë në shfrytëzim palëve të treta listën me emra kujt ju kanë japë edhe sa parcela janë jap.Kishte qenë mirë edhe materialin me na sjellë vetëm përgjigjien e kam fjalën.

**z.Florim Shala:**Për emrat e rrugëve vetëm Juniku ka mbetë.

**z.Muharrem Krasniqi:**Ka kalu ajo në kuvend fillon vitin e ardhshëm me i qitë tabelat.

**z.Zenel Maloku:**Po dua me thënë kjo është kohë e gjatë për punë të emrave që ka qenë ai djali a e keni marrë dikënd në vend tijë.

**z.Muharrem Krasniqi:**Rrugët janë të definune i kemi qitë në Kuvend.

**z.Tahir Isufaj:**Nuk e di që kam bërë ndonjë mungesë,nuk e di që ka qenë një material.As emrat e rrugëve nuk i di.

**z.Muharrem Krasniqi:**Ke qenë këtu si grup po e keni lëshu mbledhjen.

**z.Zeqë Hebibi:**Na kanë ardhë gjithmonë shtesë,masi kemi ardhë këtu nuk kemi mundur me e përcjellë se aty kanë qenë dallavere.

**znj.Behare Qestaj:**Me falni se po ndërhyj po materiai ka ardhur në shtëpi jo në mbledhje.

**z.Zenel Maloku:**Anëtarë për komision për emërtimin e rrugëve zonja Jasiqi krejt emrat e rrugëve i ka lexuar atë ditë,tjetër gjë kush nuk ka qenë këtu.

**z.Zeqë Hebibi:**Në bazë teje një votues këtu i parregullt i paligjshëm për hatër dikujt po bëhesh ti shok.Kjo është ajo mbledhja që e kemi lëshu.Kryesues ti prej fillimit deri mbarim ke leju me e i sjellë 100 fletë. Listën që e ka kërku Erleta subvencioneve mbledhjen e kaluar ku është.

**z.Muharrem Krasniqi:**Nuk ma kan sjellë nuk e kam shënu në mbledhjen e ardhshme e sjellim.

**znj.Leonita Jasiqi:**Ato janë krejt raste më shumë për njerëz që kanë pasë nevoja të domosdoshme të sëmundjes edhe gjithmonë i kemi sjellë edhe vitin e kaluar.

**z.Zeqë Hebibi:**Me 15 vota e kemi votu për edhe nuk ka ardhë.Ti na the neve ja dërgoj kryetarit edhe na sjellë në mbledhje.

**z.Florim Shala:**Drejtor a bën me e ditë sa njerëz janë të sëmurë,sa kanë vdekë dhe sa janë shëruar.

**z.Zenel Kuçi:**Raporti që ka qenë në mbledhjen e kalune i ke gjitha të dhënat.Numri i të infektuarve aktiv është 4 vetë.

**z. Muharrem Krasniqi:**A ka dikush diçka tjetër, nëse jo me kaq e mbylli këtë mbledhje



Takimi përfundoi me punë në ora 15.00

E përgatiti:  
znj. Mehrije Bajraj

---

Kryesues i Kuvendit:  
z.Muharrem Krasniqi

---



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

|                        |                                                    |
|------------------------|----------------------------------------------------|
| REFERENC-Ë:            | Nr. I-180/01/21                                    |
| DATË:                  | 18.01.2021                                         |
| PËR/ZA/TO:             | <b>z.Muharrem Krasniqi - Kryesues i Kuvendit</b>   |
| CC:                    |                                                    |
| PËRMES/PREKO/THROUGH:  |                                                    |
| NGA/OD/FROM:           | <b>z.Agron Kuçi – Kryetar i Komunës së Junikut</b> |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Kërkesë                                            |

Bazuar në nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Nr. 03/L-040), neni 42, pika j) të Statutit të Komunës së Junikut, (Nr. 001/3127, të datës: 29.9.2010), neni 16 rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës Junikut ju bëjmë këtë:

KËRKESË

Që të vendosni në rendin e ditës në mbledhjen e radhës se Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit Komunal kërkesën për:

**Ndarjen e mjeteve për banorët e Komunës së Junikut të silet janë të infektuar me Covid 19, si dhe familjet e atyre të cilet humben betejën me Covid 19.**

Qëllimi i ndarjes se ketyre mjeteve është që sadopak të ndihmohen pacientet të cilet janë duke u përballur me kete smundje dhe familjaret e atyre qe humben jeten si pasoj e infeksionit Covid 19.

Me respekt!



REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA JUNIK / OPŠTINA JUNIK / MUNICIPALITY OF JUNIK

01/Nr. Proje: 2-155/186  
Një. Org: 2  
Nr. i faq: 23  
Data: 12/01/2021



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

|                        |                                                               |
|------------------------|---------------------------------------------------------------|
| DATË/A:                | 12.01.2021                                                    |
| REFERENC-Ë:            | Nr. IV- 1/21                                                  |
| PËR/ZA/TO:             | z.Muharrem Krasniqi – Kryesues në Kuvendin Komunal të Junikut |
| CC:                    | Anëtarët e Kuvendit Komunal në Junik                          |
| PËRMES/PREKO/THROUGH:  | Agron Kuçi – Kryetar i Komunës së Junikut                     |
| NGA/OD/FROM:           | Leonard Llojuni – Drejtor për Zhvillim Ekonomik               |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Plani për Zhvillim Ekonomik Lokal Leximi i dytë               |

**Të nderuar ,**

Ju lutem gjeni të bashkangjitur me këtë shkresë Planin për Zhvillim Ekonomik 2020-2025, leximi i dytë, Plan ky që ka marrë dritën e gjelbert nga Kuvendi Komunal për t'u inicuar dhe hartuar.

Me respekt



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY JUNIK

---

## DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

### Plani për Zhvillim Ekonomik Lokal 2020-2025

Komuna e Junikut

#### LEXIMI II

Drejtori:

Leonard Lolluni



Janar 2021

# Përmbajtja

|                                                                                                 |    |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Përmbledhje Ekzekutive.....                                                                     | 3  |
| Qëllimi i planit për Zhvillim Ekonomik në Komunën e Junikut.....                                | 4  |
| Lokacioni – Pozita gjeografike.....                                                             | 5  |
| Karakteristika Gjeografike.....                                                                 | 5  |
| Lumejtë dhe sipërfaqet ujore.....                                                               | 6  |
| Përbërja e tokës.....                                                                           | 6  |
| Flora dhe Fauna.....                                                                            | 6  |
| Kapacitetet njerzore dhe financiare të Komunës për të zbatuar planin për zhvillim Ekonomik..... | 6  |
| Trendët dhe prognozot demografike.....                                                          | 7  |
| Zhvillimi Ekonomik, përmbledhje dhe vlerësimi i Ekonomisë lokale.....                           | 7  |
| Resurset Natyrore, potencialet për zhvillimin e turizmit.....                                   | 9  |
| Industria dhe Prodhimtaria.....                                                                 | 10 |
| Gjendja sociale në Komunën e Junikut.....                                                       | 10 |
| Zonat me potencial zhvillimi të turizmit natyrorë.....                                          | 11 |
| Trashëgimia Kulturore.....                                                                      | 12 |
| Shqyrtimet teknologjike dhe mjedisore.....                                                      | 13 |
| Trendi i turizmit në Junik.....                                                                 | 13 |
| Analiza e përparësive,dobësive,mundësive dhe rreziqeve (SWOT).....                              | 14 |
| Analiza për turizmin natyrorë, rural, sportive rekreativ verorë dhe dimërorë.....               | 14 |
| Dobësitë dhe rreziqet për turizmin natyrorë,rural dhe sportive rekreativ.....                   | 15 |
| Parime për turizmin e qëndrueshëm.....                                                          | 16 |
| Vlerësim i gjendjes.....                                                                        | 17 |
| Çështjet për trajtim.....                                                                       | 19 |
| Sfidat dhe identifikimi i nevojave që duhet adresuar.....                                       | 21 |
| Vizioni, Misioni dhe synimet strategjike për Zhvillimin e Turizmit të qëndrueshëm në Junik..... | 22 |

## Përmbledhje ekzekutive

Komuna e Junikut prioritet kryesor edhe në planin Zhvillimor Komunal e ka Zhvillimin e sektorit të Turizmit dhe sektorit të Bujqësisë. Gjetjet e këtij plani për Zhvillim Ekonomik duke u bazuar në sektorin e Turizmit në Komunën e Junikut sugjerojnë që zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit të turizmit duhet të bazohet në burimet natyrore dhe trashëgiminë kulturore, të cilat përfaqësojnë përparësitë konkurruese të Komunës së Junikut.



Burimet natyrore përfshijnë terrenet malore që mbulojnë Parkun Kombëtar të Bjeshkëve të Nemuna, themeluar nga Kuvendi i Kosovës në dhjetor të vitit 2012, si dhe lokacione tjera në territorin e Komunës së Junikut. Ky Dokument strategjik sugjeron se ekzistojnë kondita të përshtatshme për zhvillimin e mëtejshëm të turizmit dimëror dhe verorë, duke ofruar atraksione turistike si aktivitetet e ndryshme sportive dhe rekreative, shërbime shëndetësore dhe shëruese, dhe duke promovuar eko-turizmin dhe agro-turizmin.



*Figura 1 - Maja më e lartë në Kosovë "Gjeravica 2656m" – Junik*

Burimet e trashëgimisë kulturore gjithashtu përfaqësojnë një element të rëndësishëm në tërheqjen e vizitorëve tek Komuna e Junikut, ndërsa përkundër investimeve të bëra në vitet e fundit në rindërtim dhe konservim të kësaj trashëgimie, akoma mbetet mjaftë për t'u bërë për të krijuar një pako të plotë dhe të prezantueshme të trashëgimisë kulturore për vizitorët potencial. Masa të këtilla përfshijnë investime të mëtejshme në rindërtim dhe konservim, por gjithashtu në shenjëzim dhe shpërndarje më të mirë të informatave lidhur me ndërtesat dhe lokacionet e trashëgimisë kulturore. Dokumenti sugjeron gjithashtu një numër masash për prezantim më të mirë të trashëgimisë kulturore të paprekshme, e cila në mënyrë të suksesshme mund të plotësojë atë të prekshtmen. Fusha tjera që kërkojnë përkrahje institucionale dhe koordinim më të mirë të investimeve nga sektori privat përfshijnë shërbimet e operatorëve turistik dhe shërbimeve hoteliere. Shërbimet e

operatorëve turistik duhet të plotësohen tutje me më shumë agjenci turistike “hyrëse” pasi që për momentin numri i tyre është tepër i kufizuar the plotësisht i tejkaluar në numër nga agjencitë turistike “dalëse”, si dhe nevoja për udhëzues turistik të kualifikuar për profile të ndryshme që korrespondojnë me degët e sugjeruara të turizmit. Ngjashëm, edhe industria hoteliere duhet të fuqizohet tutje duke plotësuar ofertën e tanishme me objekte të reja dhe shërbime të reja gjithashtu.



*Figura 2 dhe 3 – Kullat e Junikut si pjesë e trashëgimisë Kulturore*

Dokumenti sugjeron, bazuar në praktikat e mira të shteteve tjera, që ndërmarrje më të vogla hoteliere dhe bujtina familjare(B&B) duhet përkrahur, në mënyrë që të promovohet eko-turizmi dhe agro-turizmi, por nuk përjashton komplekse të mëdha turistike të ndërlidhura me turizmin dimëror në lokacione të përshtatshme malore në Junik.

Së fundmi, dokumenti jep rekomandime duke shqyrtuar praktikat e shteteve fqinje, lidhur me format e përkrahjes institucionale për zhvillim të turizmit, përmes themelimit të një organizate për menaxhimin e destinacionit turistik, dhe qendrën për menaxhimin e parkut kombëtar siç e parasheh ligji. Tutje, sugjerohet gjithashtu ndihma institucionale për themelimin e shoqatave të operatorëve turistik dhe të ofruesve të shërbimeve hoteliere, në mënyrë që të promovohet më mirë turizmi në rajon.

## Qëllimi i planit për Zhvillim Ekonomik në Komunën e Junikut

Duke konsideruar pozicionin strategjik të Bjeshkëve të Junikut, si pjesë e rëndësishme e rajonit që rishtazi janë shpallur "Park Kombëtar" të cilat shtrihen përgjatë kufirit me Shqipërinë dhe Malin e Zi, duke marr parasysh edhe një numër të projekteve në fushën e zhvillimit të turizmit dhe potencialin e lartë për zhvillim të mëtejshëm, Komuna e Junikut ka karakteristika lokale dhe ndërkufitare.

Ky plan synon të krijoj kushte për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe trashëgiminë kulturore, të cilat do të mundësojnë kushte në Komunën e Junikut si destinacion turistik, dhe përmirësimin e imazhit të vendit në përgjithësi si vend i sigurt dhe atraktiv. Po ashtu synohet që të jap kontribut në kohezionin social dhe në balancën zhvillimore në rajon, si dhe në aspektin ndërkufitar.

## Lokacioni – Pozita gjeografike

Pozita: Juniku ndodhet në pjesën perëndimore të Kosovës, pranë Alpeve Shqiptare. Ka territor me sipërfaqe prej 77.77 km<sup>2</sup> dhe shtrihet në gjerësi gjeografike 42° e 22' dhe gjatësi gjeografike prej 20° 26'. Ka pozitë të përshtatshme gjeografike sepse shtrihet deri në veri-perëndim të fushës së Dukagjinit, përballë grykës së lumit Erenik, i cili buron nga Liqejtë e Gjeravicës dhe dredhon nëpër luginat e Alpeve Shqiptare. Territori i komunës së Junikut shtrihet deri në veri-perëndim të fushës së Dukagjinit, dhe kufizohet me komunën e Deçanit, komunën e Gjakovës, Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Malit të Zi. Distanca Junik-Pejë është 25 km, Junik- Gjakovë është 20 km që kalon nëpërmjet fshatit Batushë, ndërsa distanca nga Juniku deri në Rastavicë (magjistralla Pejë-Gjakovë) është 5,5 km.

## Karakteristikat gjeografike

Topografia: Komuna e Junikut ka pozitë të përshtatshme gjeografike para grykës pitoreske të lumit Erenik. Lartësia mbidetare e Junikut shkon nga 450 deri në 600 metra mbi nivelin e detit. Vet qyteza e Junikut, gjendet në lartësi mbidetare 593 m. Maja më e lartë është Gjeravica, me lartësi mbidetare 2656 m e cila është gjithashtu edhe pika më e lartë në Kosovë e Alpeve Shqiptare. Gjithashtu ekzistojnë dhe dy maja të larta në afërsi të Gjeravices, nga pjesa perëndimore Maja e Gusanit me lartësi mbidetare 2539 m. ndërsa nga pjesa veriperëndimore Maja e Rrupës me lartësi mbidetare 2501 m. Veçoritë natyrore: Juniku ka lloje të ndryshme peisazhesh, nga ai hidrografik (lumejtë Erenik dhe Travë), peisazhe fushore (fusha e Junikut) dhe peisazhe kodrinore apo malore (Gjeravica, Maja e Gusanit, Maja e Rrupës, Rrasa e Zogut, Jedova, Moronica). Me datën 28.08.2008 Kuvendi Komunal i Junikut ka shpallur Moronicën "zonë të veçantë të komunës së Junikut". Kjo zonë mendohet të jetë "parku i ardhshëm i qytezës(..) që do të jetë si urë lidhëse në mes të parkut etnografik dhe parkut nacional Bjeshkët e Nemuna". Në tërësinë e tij, Juniku paraqitet si entitet që ka qenë, është dhe do të jetë i lidhur ngushtë me natyrën. Kushtet klimatike: Juniku ka klimë kontinentale, por, me disa tipare mesdhetare. Kjo klimë është e përshtatshme për kultivimin e kulturave

të ndryshme bujqësore. Mesatarja e temperaturës është 21° C në verë dhe -11° C në dimër. Sasia mesatare e të reshurave është afër 670 mm<sup>3</sup>, kurse në sezonin e vegjetacionit (prej muajit të IV-IX) afër 330 mm<sup>3</sup>.

## Lumejtë dhe sipërfaqet ujore:

Lumi Erenik është më i madhi dhe më i rëndësishmi i rajonit, i cili shërben gjithashtu si burim uji edhe për ujitjen e fushës së Junikut. Ereniku buron nga Liqejtë e Gjeravicës. Ujërat që rrjedhin përkatësisht vijnë nga kurorat e maleve, nga Gropa e Erenikut dhe nga Alpet Shqiptare, formojnë rrjedhat sipërfaqësore të ujërave. Nëse menaxhohet mirë dhe nuk ka keqpërdorime të ujit, ka sasi të mjaftueshme edhe për ujitje dhe ujë të pijes.

## Përbërja e tokës:

Nga sipërfaqja prej 77.769,931 Ha, sa ka komuna e Junikut, afërsisht 4.439 Ha (57.08%) janë tokë bujqësore. Livadhet e kullotat zënë sipërfaqe prej rreth 2.000 Ha (45.05%) nga sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore si dhe pyjet që zënë mbi 3.029 Ha (38.95%) që paraqesin potencial për zhvillim. Në zonën urbane të Junikut dominon tokë relativisht e thellë e përshtatshme për prodhime bujqësore, ndërsa, në pjesët tjera jashtë zonës urbane dominon tokë e cekët e përshtatshme për kullosa dhe zhvillim të pylltarisë (shih më gjerësisht Kapunën 2.4.1 shfrytëzimi i tokës).

## Flora dhe fauna:

Afërsia me natyrën ka bërë të mundur që Juniku të jetë i pasur në planin e biodiversitetit. Biodiversiteti reflekton shumëllojshmërinë e qenieve të gjalla varësisht se në cilën zonë zhvillohen. Ky koncept përmbledh gjithashtu laramaninë brenda llojit, ndërmjet llojeve dhe ndërmjet ekosistemeve (elaborim më i gjerë është bërë në kapitullin e biodiversitetit).

## Kapacitetet njerëzore dhe financiare të komunës për të zbatuar planin për Zhvillim Ekonomik

Korniza afatmesme buxhetore komunale ofron një shpjegim të plotë të politikave/prioriteteve të tanishme dhe afatmesme të komunës, projeksionet lidhur me mënyrën në të cilën buxheti i komunës do të bëjë përmbushjen apo përkrahjen e prioriteteve, si dhe parashikimet rreth performancës ekonomike të komunës.

## Trendët dhe prognozat demografike

**Popullsia-Gjendja** - Sipas statistikave të vitit 1981 dhe disa shenimeve të pasluftës, kur Juniku u themelua si Pilot Njësi Komunale, numëronte rreth 12.500 banorë, përfshirë fshatrat: Gjocaj, Jasiq, Voksh, Sllup dhe

Rastavicë. Ndërsa në vitin 2008 me miratimin e Kushtetutës dhe Ligjit për Kufijtë Administrativë Juniku bëhet komunë me dy zona kadastrale. Zona kadastrale e Junikut dhe zona kadastrale Gjocaj dhe Jasiq dhe vlerësohet të ketë 9.600 banorë me diasporën (sipas LFPL).

Të dhënat e fundit zyrtare nga ESK (2009) nga anketimi "Popullsia, ekonomitë familjare sipas vendbanimeve dhe organizimi territorial i Kosovës deri në vitin 2008, tregojnë se Juniku si vendbanim ka 624 ekonomi familjare, 5423 anëtarë rezident, 1427 objekte ndërtimore, kurse fshatrat Jasiq- Gjocaj kanë 2 ekonomi familjare me gjithsej 7 anëtarë dhe 38 objekte ndërtimore. Nga ana tjetër, të dhënat e marra nga anketimi në terren për nevojat e PZHK-së, tregojnë se në Junik ka 741 ekonomi familjare me gjithsej 7138 banorë përfshi edhe diasporën. Mesatarja e ekonomive familjare është 6 anëtarë për familje.

Në tabelën e mëposhtme janë të dhënat për popullsinë sipas moshës dhe gjinisë. Më se 50% e popullsisë janë nën moshën 26 vjeçare. Raporti gjinor është pothuasje i balancuar (F:M=50.26%: 49.74%). Popullsia i përket etnisë shqiptare.

## Zhvillimi ekonomik, Përmbledhje dhe vlerësim i ekonomisë lokale

**Bujqësia:** është veprimtari e rëndësishme në komunën e Junikut. Juniku ka 4.439 Ha tokë bujqësore e cila paraqet 57.08% të sipërfaqes së përgjithshme. Ky është indeks relativisht i lartë krahasuar me mesataren në Kosovë që sillet prej 0.15-0.18 Ha tokë bujqësore për kokë banori (limiti kritik është 0.17 Ha) dhe atë në Europë (0.52 Ha/1b). Toka bujqësore pas luftës kultivohet me një shkallë më të ulët për shkak të konkurrencës joreale në treg dhe mos aplikimit të mbjellurave profitabile nga fermerët. Aktivitetet bujqësore në Junik zhvillohen qoftë në zonën urbane (për shkak të tipologjisë së banimit me oborre të mëdha) poashtu edhe atë rurale. Ndërsa kulturat më të zhvilluara bujqësore janë: gruri, misri, fasulja, thekra, pastaj perimet si: specat, domatet, lakrat dhe qepët. Në masë mesatare kultivohen kulturat e pemëtarisë si: molla, dardha, vishnja, dhe dredhëza, por, kohëve të fundit shihet tendenca e rritjes së mëtejshme të sipërfaqeve të pemishteve, me një favorizim të rritjes së kapacitetit të ujitjes. Duke iu falënderuar cilësisë së tokës dhe klimës, Juniku karakterizohet edhe me kulturat e bimëve me veti mjekuese si: lincuri, rrudhani dhe disa lloje të këpurdhave.

**Perimekultura/Lavërtaria:** Në komunën e Junikut nuk është ende aq e zhvilluar perime-kultura dhe lavërtaria. Kultivohen një numër i vogël bimëve lavërtare. Në sipërfaqe të vogla bimë foragjere dhe pemë. Mbi 45 Ha janë të mbjella në sektorin privat. Interesimi i ulët i fermerëve për kultivim ndodh edhe për arsyet e kostos së lartë të shpenzimeve. Ajo që vihet re është zhvillimi i pakët i kulturave intensive dhe industriale e sidomos kultivimi në ambiente të mbyllura – serra.

**Qasja në tokat bujqësore:** Problematikë në vete paraqet qasja në tokat bujqësore. Kjo për arsye se në mungesë të rrugëve, pronarëve iu duhet të kalojnë nëpër pronat e tjetërkujt për të pasur qasje në tokën

e vet. Ky problem është sidomos gjatë sezonit të të korrave. Poashtu pamundësia për plasimin e produkteve në tregun kosovar dhe atë rajonal paraqet një dobësi për sektorin e bujqësisë.

**Sistemi i ujitjes së tokave bujqësore:** Nën sistemin e ujitjes janë 960 Ha tokë punuese. Komuna në këtë aspekt është duke u ndihmuar nga Ministria e Bujqësisë me ndërtimin e pendës në lagjen Gacafer. Me këtë projekt priten të futen në sistemin e ujitjes, pjesë e madhe e tokave bujqësore. Realizimi i këtij projekti padyshim që do ta përmirësojë pak situatën, por, jo në tërësi. Ka nevojë për ngritjen e kanaleve që do ta dërgonin ujin në çdo pjesë të tokave bujqësore. Kështu fermerëve do t'iu lehtësohet puna për zënien e ujit nga lumi Erenik dhe futjen e ujit në sistemin e ujitjes. Ka vite që ujitja e tokave bujqësore bëhet nga ky lum meqë sasia e ujit është e mjaftueshme për ujitje. Nevojitet që kanalet kryesore dhe ato ndihmëse të rregullohen dhe mirëmbahen.

**Blegtoria:** Përkundër faktit që ajo pësoi dëme shumë të mëdha gjatë luftës (dëmet rezultuan me humbjen e rreth 90% të gjedheve, 85% të deleve, 100% të pulave dhe rreth 50% të dhive) blegtoria paraqet një drejtim tjetër strategjik të zhvillimit ekonomik të komunës së Junikut. Sipërfaqja e madhe me livadhe e kullota brenda territorit të komunës si dhe nga tradita e zhvillimit të kësaj lëmie janë faktorë favorizues për zhvillimin e blegtorisë (sidomos në kultivimin e gjedheve dhe dhenve). Sipas të dhënave nga Strategjia Zhvillimore Lokale (2009), në Junik ekzistojnë 200 ferma të vogla dhe dy ferma të mëdha të specializuara.

**Organizimi:** Në këtë drejtim është më e rëndësishme të shikohen edhe çështjet nga aspekti institucional dhe organizativ. Stimulimi i bujqëve dhe fermerëve nga ana e Ministrisë (MBPZHR) për rritjen e shfrytëzueshmërisë së tokës bujqësore respektivisht ngritjen e fermave duke respektuar standardet e BE, është i ulët. MBPZHR me politikat e saj stimulon fermerët të kategorisë së mesme dhe të lartë, gjë që nënkupton që fermerët e vegjël duhet të bashkojnë fermat e tyre duke u organizuar në formë kooperativash. Sipas parametrave të MBPZHR, Juniku nuk ka nevojë për më shumë se dy ferma. Sipas informatave nga komuna e Junikut, mendohet se ekzistojnë rreth 800 dele të shpërndarë në 5 fermerë dhe diku 1100 lopë në rreth 90 fermerë të kësaj komune. Janë gjithsej pesë fermerë që kanë mbi 10 krerë lope qumështore të cilët kanë përfituar nga stimulimi i MBPZHR. E rëndësishme të ceket është edhe mungesa e organizimit: në Junik ende nuk ka shoqatë të bujqve dhe fermerëve dhe fusha e bujqësisë mbulohet me vetëm një punëtor profesional në kuadër të komunës. Shqetësim paraqet edhe fakti që bujqësia nuk shihet si profesion profitabil nga të rinjtë.

**Pylltaria:** Potenciali pyjor në nivel të Kosovës është 41.8% me rreth 455 000 Ha. Pyjet (respektivisht kulturat pyjore ku përfshihen edhe masat drunore në tokat bujqësore), në komunën e Junikut zënë sipërfaqe prej 3197 Ha që i bie rreth 41% të territorit të komunës së Junikut). Në pronësi private janë rreth 22% e pyjeve. Rreth 50% e pyjeve janë të reja rreth moshës 30 vjeçare me lloje të drurit të ahut, gështenjës, dushkut dhe verrit. Llojet më të përhapura janë: Ahu (dominon në 79 % të sipërfaqes pyjore), halorët : Pisha e Zezë, Hormoqi, Bredhi, Arneni (rreth 20 % të sipërfaqes në pyjet publike). Gështenja, Dushku e Verri janë kryesisht në pronësi private, ndërsa Mështekna si dhe gjethor dhe halor të tjerë kryesisht në pronësi publike dhe në sipërfaqe të vogla. Për të gjitha llojet ekzistojnë kushte optimale për rritje të drurëve të një kualiteti të lartë. Rritje vjetore e masës drurore në gjithë sipërfaqen pyjore është ~5.07 m<sup>3</sup>/Ha. Potenciali i zhvillimit të pylltarisë në Junik në favor të zhvillimit të industrisë së drurit dhe përpunimit final ende nuk është hulumtuar. Aktualisht ato shfrytëzohen për prodhimin e drurit për djegie,

meqë, tregu dhe organizimi i mirëfilltë që një sasi e konsiderueshme nga pyjet e ahut të shfrytëzohet për nevoja të industrisë së drurit mungon.

Nga ana tjetër vështirësitë në zhvillimin e këtij sektori, shihen edhe tek kompetencat në menaxhim të pyjeve që tash vonë janë deleguar tek komuna dhe deri tani kanë qenë kompetencë e nivelit qendror. Transferimi i kompetencave për mbrojtjen e pyjeve dhe shfrytëzimin jep mundësi për të krijuar një situatë të re sidomos në pyjet në pronësi publike. Është me se e nevojshme që rolet dhe përgjegjësitë për të gjitha palët e përfshira të sqarohen dhe kuptohen sepse menaxhimi i pyjeve ka nevojë për të adresuar si potencialin e zonës poashtu edhe nevojat e komunitetit për produktet pyjore dhe shërbimet për një menaxhim të qëndrueshëm. Modeli aktual i menaxhimit të pyjeve për tu aplikuar në këtë situatë të re me kompetencat e decentralizuara për pyjet akoma nuk është i sqaruar. Ngritja e kapaciteteve Komunale për menaxhim pyjesh është esenciale. Sektori i pyjeve private është dobët i organizuar dhe me institucionalizim të kufizuar që shpie tek një Sektor i pylltarisë që nuk siguron kuadër dhe shërbime të nevojshme optimale për sektorin privat. Shumica e pyjeve kanë menaxhim të pa qëndrueshëm dhe prerjet ilegale mbesin problem serioz. Në sektorin privat të pyjeve kjo ndodh për shkak që korniza ligjore e sektorit privat dhe e decentralizimit të menaxhimit të pyjeve nuk është e rregulluar plotësisht. Ekziston një nivel i ulët i përfshirjes së akterëve vendor, siç janë komunat dhe komunitetet në sektorin e pylltarisë duke rezultuar në rregullim të limituar të menaxhimit të pyjeve lidhur me nevojat e këtyre akterëve dhe duke i kufizuar mundësitë për zhvillim ekonomik. Hapat e parë në zhvillimin e pylltarisë private janë hedhja me themelimin e Shoqatës së Pronarëve të Pyjeve me përkrahjen e projektit të SNV –SIDA, për forcimin e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve. Zhvillimi i sektorit privat dhe decentralizimi pyjeve i ep një mundësi të mirë zhvillimit ekonomik rural. Sidomos në zonat e largëta, sektori i pylltarisë është një ndër sektorët që siguron të ardhura dhe mundësi punësimi. Aktualisht, për shkak të kushteve të kufizuara, pyjet nuk përdoren dhe nuk menaxhohen në mënyrë të duhur (ka degradim dhe shërrim resursesh pyjore). Kushtet e duhura (institucionale, sociale dhe ekonomike) mund ta ndryshojnë këtë, ku pyjet private dhe të decentralizuara janë duke kontribuar në ekonominë rurale dhe duke i ruajtur shërbimet pyjore në dobi të shoqërisë duke kontribuar në mirëqenien sociale dhe ekonomike.

**Silvikultura:** Silvikultura është e zhvilluar në Junik. Në këtë territor funksionojnë dy fidanishte. Ndërmarrja “PTUJA” dhe “FIDANISHTJA” që kanë nga 0.50 deri në 0.60 Ha toke fidanishte të silvikulturës.

## Resurset natyrore, potenciale për zhvillimin e turizmit

Aktualisht turizmi nuk është sektor i zhvilluar aq sa duhet në Komunën e Junikut edhe pse potenciali natyror dhe ai kulturor ekziston. Potenciali turistik i komunës së Junikut është ngushtë i lidhur me pozitën gjeografike dhe vlerat kulturore e natyrore të komunës të cilat ofrojnë kushte për zhvillimin e turizmit malor/veror dhe dimëror, turizmit rekreativ dhe atij kulturor. Shikuar në aspektin e zhvillimit turistik komuna e Junikut ndahet në tri zona me lokalitetet turistike: zona urbane: me potencialin e zhvillimit të turizmit kulturor dhe atij rekreativ; Zona Gryka e Junikut me lokalitetet turistike: Liqejtë e Gjeravicës, Burimet e Erenikut, Lugu i Gjatë dhe Rrasa e Zogut, si dhe Zona e Zharres me lokalitetet: Gradina, Jedova, Zharra, Jasiq dhe Gjocaj (shih më gjerësisht kaptinën e potencialit natyror). Aktualisht komplekset/zonat më të vizituara nga turistët janë: Maja e Gjeravicës me dy liqejtë natyror; lumi Erenik, Moronica, Kullat, etj.

Sektori i turizmit është ngushtë i lidhur me zhvillimin e hotelierisë dhe gastronomisë (kuzhinës). Hotelet dhe objektet që ofrojnë shërbime hotelierike në Junik janë: Motel Restaurant Oda e Junikut; Motel Gjeravica dhe Konaku i Ramë Zymberit të cilat menaxhohen nga sektori privat. Kapaciteti i këtyre objekteve hoteliere është i kënaqshëm. Meqë turizmit i është dhënë prioritet si sektor i zhvillimit në të ardhmen, atëherë duhet marrë parasysh edhe ngritjen e kapaciteteve hoteliere. Përveç hotelierisë, faktorë tjerë të cilët gjithashtu ndikojnë në zhvillimin e turizmit janë: qasja (arritshmëria) deri te objektet/lokacionet turistike; konkurrenca; promovimi (marketingu); aktivitetet (ngjarjet kulturore, sportive, argëtuese etj) etj. Këto elemente mungojnë shumë në Junik ndaj ka nevojë për veprime të menjëhershme në këto fusha.

## Industria dhe Prodhimtaria

Në komunën e Junikut industria nuk është e zhvilluar. Ekziston një kompani e cila merret me përpunimin e asfaltit dhe zhavorit dhe gjithashtu është në finalizim e sipër Fabrika për mbushje dhe ambalazhim të ujit dhe lëngjeve të frutave. Punësimi në kompanin e zhavorit bëhet në bazë të nevojave dhe është kryesisht sezonal. Siç u cek më lartë potencial për zhvillimin e industrisë së drurit ende nuk është hulumtuar. Nga ana tjetër nëse rritet fondi i blegtorisë ka mundësi për zhvillimin e industrisë së mishit në të ardhmen.

## Gjendja Sociale në Komunën e Junikut

**Punësimi dhe papunësia:** Ashtu sikur në tërë Kosovën, shkalla e papunësisë edhe në komunën e Junikut është e lartë dhe paraqet një aspekt shqetësues. Nga të dhënat e marra në terren nga anketimi del se nga popullsia aktive për pune (të moshës 19-64 vjeç) vetëm 22.76% e tyre janë të punësuar respektivisht të papunë janë 77.24% e popullsisë aktive. Nga 22.76% e të punësuarve, 4.03% janë femra ndërsa 18.73% meshkuj që do të thotë se raporti i punësimit sipas gjinisë është gati F:M=1:5. Deri sa ishin në funksion kapacitetet prodhuese, numri i të punësuarve ka qenë shumë më i madh e sidomos në Fabrikën e Konfeksionit në Junik ku kanë punuar më tepër se 230 punëtorë. Në mungesë të punësimit në këto kapacitete një numër i të punësuarve kanë gjetur mundësinë e punësimit në bizneset e vogla private.

**Të ardhurat:** Të ardhurat kryesore vijnë nga përpunimi dhe tregtimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale. Mirëpo duke pasur parasysh numrin e madh të junikasve që gjenden jashtë vendit (përgjithësisht në Zvicër dhe Gjermani), konsiderohet që ndihma ekonomike që vjen nga burim të ardhurash të rëndësishme për komunën. Sipas anketimit, rezultatet mbi të ardhurat mesatare familjare janë si vijon:

**Varfëria dhe asistenca sociale:** Sipas të dhënave nga Qendra për Punë Sociale e komunës së Junikut, gjithsej janë 685 individë apo 12.6% e popullsisë rezidente në Junik që jeton në varfëri. Kjo vlerë tregon se kemi të bëjmë me shkallë të mesme të varfërisë meqë % e popullsisë që marrin asistencë sociale është në vlerat 4-22%. Rritjes së shkallës së varfërisë i kanë kontribuar: shkalla e lartë e papunësisë, shkatërrimi masiv gjatë luftës sidomos për vendbanimet Jasiq dhe Gjocaj, etj.

**Strehimi:** Komuna e Junikut nuk ka probleme të të pastrehëve dhe e gjithë popullata kanë strehim adekuat, duke marrë parasysh edhe atë se Lagjja „Agim Ramadani” është duke u shfrytëzuar në një formë si banim social dhe strehim për banorët e zhvendosur nga fshatrat Jasiq dhe Gjocaj.

**Migrimi:** Në mungesë të regjistrimit të popullsisë, nuk dihet numri i saktë zyrtar i familjeve që jetojnë në diasporë. Sipas anketimit të bërë në terren për nevojat e këtij plani del se 25% e popullsisë së Junikut jeton jashtë Kosovës dhe interesimi për të migruar jashtë në kërkim të kushteve më të mira për jetë dhe gjetjen e mundësive për punësim është ende prezent. Kjo sipas anketimit është shprehur në gati 12% të familjeve, të cilat kanë deklaruar se kanë të interesuar për të migruar jashtë vendit, e shprehur sidomos tek rinia mashkullore.

**Organizimi i shoqërisë civile:** Shoqëria civile në komunën e Junikut nuk është e organizuar dhe si e tillë nuk është edhe shumë aktive. Ndoshta një gjendje e tillë ndodh për shkak se Juniku është komunë e re dhe se deri më tani nuk ka pasur kapacitete të zhvillohet ky sektor me rëndësi për shoqërinë.

## Zonat me potencial zhvillimi të turizmit natyror

Shpatijet e përshtatshme për zhvillimin e sporteve dimërore dhe rekrejuese (ngjitje në bjeshkë), Liqejtë e bukura të Gjeravicës, burime e rrjedha lumejsh, gryka, pyje të larta dhe një faunë e shumëllojshme e bëjnë Junikun zonë atraktive me mundësi të zhvillimit të turizmit gjatë gjithë vitit. Sipas konceptit të punuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, lokalitetet me potencial të rëndësishëm të zhvillimit të turizmit bazuar në trashëgiminë natyrore janë:

- Hapësira urbane me trashëgiminë kulturore (kullat, mullitë, vajavicat)
- Lokalitetin Moronica që paraqet potencial të mirë për pushim dhe rekreacion. Fauna e pasur e kësaj zone ofron mundësi për ndërtimin e një kopshti zoologjik.
- Lokaliteti Lugu i Erenikut që ofron mundësi të mira për ngritjen e një qendre për sport e rekreacion dhe në veçanti zhvillimin e sporteve ujore
- Lokaliteti i Gradinës paraqet potencial për sport e rekreacion (sport ujqor, peshkim, gjueti),
- Lokaliteti Jedova- potencial për zhvillimin e turizmit alpin, turizmit rekreativo-kurativ, gjueti etj.
- Lokaliteti Gropa e Erenikut dhe Rrasa e Zogut për shkak të pozitës gjeografike paraqet një lokalitet me vlera të larta turistike si dhe mundësi për zhvillimin e bashkëpunimit ndërkufitar mes Kosovës, Shqipërisë dhe Malit të Zi. Gjithashtu ka mundësi për zhvillimin e ekoturizmit. Sipas raportit të lartpërmendur, dhe duke iu referuar studimeve ndërkombëtare të bëra në vitet '70, në rajonin turistik të Junikut Rrasa e Zogut paraqet një vend me mundësi për ngritjen e një qendre turistike.
- Lokaliteti Burimi i Erenikut dhe Liqejtë e Gjeravicës ofrojnë mundësi për zhvillimin e ekoturizmit, turizmit alpin për shkak të Majës së Gjeravicës si dhe aplikimin e gjuetisë dhe bashkëpunim ndërkufitar.

- Lokaliteti Gjocaj dhe Jasiq janë lokalitete të cilat ofrojnë mundësi për zhvillimin e turizmit rural dhe ekoturizmit, zhvillimin e gjuetisë dhe turizëm konferencial.
- Lokaliteti Zharra për shkak të karakteristikave gjeo-morfologjike, paraqet potencial për zhvillimin e turizmit rural dhe ekoturizmit, turizmit konferencial, si dhe mundësi për ngritjen e një Qendre rekreative-rehabilituese.

## Trashëgimia kulturore

Sipas Ligjit për Trashëgiminë Kulturore në kuadër të trashëgimisë kulturore përfshihen: trashëgimia arkitekturale, arkeologjike, peisazhet kulturore si dhe trashëgimia shpirtërore,

- Trashëgimia arkitekturale (monumentet; ansamblet ose tërësia e ndërtesave; hapësirat arkitekturale konservuese të cilat dallohen për nga vlerat historike, arkeologjike, artistike, shkencore, me interes shoqëror ose teknik)
- Trashëgimia arkeologjike (ndërtimet, strukturat dhe grupet e ndërtesave, vendbanimet e zhvilluara, objektet e luajtshme, monumentet e llojeve të ndryshme dhe përbërjeve të tyre, të gjetura në tokë ose nën ujë.
- Peisazhet kulturore nënkuptojnë një fushë, ashtu siç perceptohet nga njerëzit, karakteri i të cilës është rezultat i ndërpërimit dhe ndërveprimit të faktorëve natyrorë dhe/ose njerëzorë; një komponentë esenciale e ambientit të njerëzve, një shprehje e diversitetit të trashëgimisë së përbashkët të tyre kulturore e natyrore, dhe një krijues i identitetit të tyre.
- Trashëgimia shpirtërore e cila përfshin format e shprehjes kulturore të traditave ose të zakoneve popullore, të gjuhës, festave, riteve, valles, muzikës, këngës dhe shprehjes artistike.

Juniku edhe pse komunë relativisht e vogël me territor, karakterizohet me vlera të shumta të trashëgimisë kulturore dhe asaj shpirtërore. Llojet e trashëgimisë që mund të hasen në Junik janë: trashëgimia arkitekturale, arkeologjike si dhe ajo shpirtërore. Trashëgimia kulturore e Junikut lidhet shumë me zhvillimin historik të tij. Në kaptinën e historikut u cek se Juniku paraqet një vendbanim të lashtë ilir. Dëshmi të kësaj janë materialet arkeologjike të zbuluara tek vendbanimi ilir i quajtur "Gradina", vendbanim ky që ndodhet në grykën e majës së Gjeravicës gjurmët e të cilit ekzistojnë edhe sot. Në periudhën e feudalizmit, Juniku paraqitet si një qendër e rëndësishme e pazarit. Në atë periudhë edhe ndërtohet Xhamia e Qokut dhe Xhamia në Qendër të Junikut, që edhe sot paraqesin objekte me vlera të rëndësishme kulturo-historike. Trashëgimia me të cilën Juniku spikatet janë: kullat, banesa të fortifikuara familjare, tipike për rrafshin e Dukagjinit), pasuar me shtëpitë e gurit, objektet tradicionale për shërbime dhe mullinjte.

**Kullat**- janë objekte tradicionale me bazë katrore dhe elemente përcjellëse arkitektonike sikurse dyshekllëku, shkallët e jashtme etj. Në Junik kullat më të vjetra janë ato të lagjes së Hoxhajve, që datojnë nga fundi i shekullit të XVIII-të. Kullat përveç interesit arkitektonik, kanë luajtur edhe një rol të rëndësishëm shoqëror. P.sh. Kulla "Oda e Junikut" ishte njëkohësisht institucion juridik, shoqëror dhe politik. Aty u mbajtën tubime të ndryshme me rëndësi jo vetëm për Junkun, por edhe për tërë Kosovën. Kulla si banesë e fortifikuar është i vetmi tip arkitekturor banesë të shqiptarët që përfaqësohet në treva

të caktuara në të gjitha shtresat popullore dhe pikërisht për këtë kulla edhe quhet banesë e të gjitha shtresave shqiptare.

## Shqyrtimet teknologjike dhe mjedisore

**Teknologjia e re informative** ndërlidhet me çështjen se sa kulturalisht dhe profesionalisht popullata e Junikut është e gatshëm dhe e përgatitur të përdorin avantazhin e teknologjisë informative, cili është kualiteti i informatave të shkëmbyera, niveli i përdorimit të saj për hulumtim dhe sa është duke u përdorur për promovim, marketing, informim të publikut të gjerë, tërheqje të turistëve për të vizituar trashëgimin natyrore dhe kulturore në rajon si dhe për produktet dhe ofertën turistike të tij. Vlerësohet se qasja dhe përdorimi i internetit për marketing është e ulët, ndërsa të gjitha komunat janë të pajisura me faqe interneti. Sasia, kualiteti, frekuenca e përditësimeve dhe përdorshmëria këtyre faqeve të internetit varion nga një komunë në tjetër dhe konsiderohet se ka nevojë të zhvillohen e veçanërisht sektori i turizmit dhe kulturës por dhe të tjerët.

**Gjendja e mjedisit** në Junik karakterizohet si jo e knaqshme, me ndotje nga hedhurina, pyje në degradim, lumenj të gërryer, ndotur dhe humbje uji, ndërriin destinimi dhe parcelizim i tokës bujqësore, ndërtime të egra, etj. prandaj edhe në brendi të zonave të mbrojtura natyrore, prandaj lumenjve dhe rrjedhave ujore tjera duke ndotur dhe rrezikuar jetën e gjallë në to si dhe ndojen e tokës bujqësore dhe fruta perimeve nga ujitja me këto ujëra të ndotura që ka ndikim edhe në shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve veç. Një dukuri në rritje është mos përfillja e planeve dhe standardeve hapësimore, mjedisore, teknike, ndërtuese, etj. Karakteristikë tjetër është mungesa e trajtimit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave familjare, ujërave të zeza dhe atyre industriale si dhe mbetjeve inerte duke përfshi riciklimin e kufizuar. Ndryshimi substancial i gjendjes mjedisore mbetet parakusht për zhvillimin e turizmit dhe zhvillimin e gjithëmbarshtëm socio-ekonomik, tërheqjen e investimeve dhe të turistëve. Për më tepër, mjedisi është një nga faktorët e fortë në sigurinë njerëzore dhe imazhin e Junikut si një vend me vision dhe plane afatgjata atraktiv për të jetuar, punuar, investuar dhe relaksuar.

## Trendi i turizmit në Junik

Në bazë të pozitës gjeografike, gjeomorfologjisë, klimës, pasurive natyrore dhe kulturore të mbrojtura me ligj në Junik, si dhe në bazë të vendndodhjes strategjike në trekëndëshin kufitar, potenciale janë turizmi malor veror, dimëror-sportiv (ski, ecje me rrathë), kulturor, rural, rehabilitues dhe kurativë, ekskursionist rekreativ, alpin (ngjitje bjeshkëve dhe shkëmbinjve), fluturimi me parashutë, speleologji, gjueti dhe peshkim, konferencier, turizmi transit, etj. Zinxhiri i ofruesve të shërbimeve turistike në Junik përbëhet nga ata direkt si ndërmarrjet e vogla dhe të mesme hoteliere dhe bujtina familjare që ofrojnë akomodim dhe ushqim respektivisht, operatorët turistikë (disa shoqata dhe agjenci turistike) si dhe individët si udhëzues, përkthyes. Agjencitë turistike ofrojnë shërbime biletash për udhëtim tokësor dhe ajror jashtë vendi duke promovuar

ofertat dhe paketat turistike të huaja. Indirekt në industri përfshihen shërbimet komunale, transporti publik, infrastruktura, prodhuesit dhe tregtuesit ushqimor, etj. Një rol të rëndësishëm mbështetës dhe përfshirje direkte kanë zyrat informative turistike. Në Junik ekziston një qendër rajonale turistike në Junik që është mesatarisht e pajisur me materiale dhe informacion turistik.

## Analiza e Përparësive, Dobësive, Mundësive dhe Rreziqeve (SWOT)

Analiza e gjendjes dhe potencialeve është përdorur për identifikimin e pikave të forta, dobësive, mundësive dhe rreziqeve (PDMRr/anglisht SWOT) që ndikojnë në arritjen e objektivave strategjike për zhvillimin e turizmit në Junik dhe përfshin edhe rezultatet e analizës PESTAL. Pikat e dobëta mund të kthehen në të forta përmes veprimeve të identifikueshme, në të kundërtën të rrezikojnë procesin në mungesë të veprimeve të nevojshme adekuate nga të gjithë palët si pastrimi dhe mbajtja pastër e mjedisit. Njëlloj, mundësitë mund të kthehen në rreziqe si p.sh. eksploatimi i burimeve natyrore dhe kulturore si dhe efektet anësore në mjedis, kulturë dhe shoqëri nga rritja e numrit të turistëve, ndërtimet dhe veprimtaria e ndërmarrjeve turistike.

## Analiza për turizmin natyror, rural dhe sportivo rekreativ veror dhe dimëror

- Pozita e mirë gjeografike e Bjeshkëve të Nemuna dhe mundësi për pushim dhe rekreacion;
- Shpallja e Bjeshkëve të Nemuna (Bjeshkët e Junikut) “Park Kombëtar” (dhjetor 2012);
- Ujërat e lumenjve, përroskave, krojeve dhe liqeneve janë faktor i rëndësishëm atraksioni;
- Mundësi gjuetie në male dhe peshkimi në lumenjtë malor dhe fushor;
- Mundësi për investime të kombinuara në rekreacion, shëndet dhe rehabilitim nga partnerët e turizmit dhe shëndetësisë (iniciativa të përbashkëta biznesi);
- Disa shtigje të ndërtuara për ecje, çiklizëm dhe mundësi për të tjera dhe kalërim;
- Peizazhi i maleve dhe fushës së Junikut të lidhura mirë me objektet e trashëgimisë kulturore si kullat, muzetë, objektet e kultit, objektet tjera, etj.;
- Mundësia e udhëtimit në rrugët e vjetra tregtare në këmbë dhe me kuaj në Junik dhe përtej kufirit shtetëror me Shqipërinë dhe Malin e Zi;
- Një nivel i ngritur i të kuptuarit të rroleve, rëndësisë dhe nisma bashkëpunimi dhe partneriteti pushtet lokal, biznes dhe shoqëri civile dhe të tjera, ndonëse jo kënaqshëm;
- Pista e skijimit, shërbime pajisjesh dhe trajnim për skijim;
- Diaspora përbën një potencial të veçantë investues në turizëm në rajon; - Rritja e interesimit të banorëve dhe ofrimi i shtëpive, tëbanave dhe kullave me/pa ushqim (B&B) si dhe përfshirja në jetën lokale sidomos në ambientet fshatare;
- Akomodim në hotele, motele, fshatra turistike si dhe vila në zona atraktive turistike;
- Përjetimet mbresëlënëse nga mikpritja dhe ushqimi tradicional;

- Eksperiencë individuale, grupe dhe familjare në “eko” dhe “agro” turnetë e organizuara nga ofruesit e shërbimeve individuale dhe operatorët turistik të pakët në Junik;
- Aktivitete të llojit të veçantë gjatë vizitës/pushimit si çiklizëm, peshkim, ecje, vrapim dhe kalërim.
- Turne eksplorues dhe studiues të agrikulturës, mbledhjes së çajrave, frutave të malit, bimë mjekuese, etj.;
- Mundësi të turizmit konferencier (ndonëse tani e limituar) në hotelet dhe restorantet e mëdha, me pajisje zërimi, projektimi, etj. me kapacitet deri 400 veta;
- Mundësi për aktivitete planifikuese disa ditore, ndërtim ekipi përmes aktivitete në natyrë, trajnime në grupe të vogla dhe të mesme në zona tjera turistike në Junik si dhe trashëgimia natyrore dhe kulturore atraktive në mjedisin rrethues ku ndodhen konferencat;
- Ekziston infrastruktura bazike, me nevoja përmirësimi në aspekte të ndryshme përfshi sinjalizime, siguri, etj.;
- Terrene të përshtatshme për shtigje skijimi dhe reshje bore të mjaftueshme;
- Kushtet e përshtatshme klimatike, siguria dhe afërsia territoriale me qendrat turistike;
- Rritja e numrit të vizitorëve vendor në zonat e bjeshkëve të Junikut etj.;
- Ekzistojnë plane komunale zhvillimore, hapësinore, urbane dhe dy plane të veprimit në mjedis.
- Ambienti dhe ajri i pastër në zonat rurale dhe malore.

## Dobësitë dhe rreziqet për turizmin natyror rural dhe sportivo rekreativ

- Implementimi i kufizuar legjislacionit si ai mjedisor, hapësinor, trashëgiminë kulturore, për parqet, etj.
- Degradimi i trashëgimisë natyrore në Junik nga vetëdija e ulët mjedisore e popullatës dhe mos kujdesi dhe ekspertiza institucionale,
- Mungesa e planifikimit hapësinor dhe kufizimit të 4 zonave të parkut BN dhe vonesa në themelimin e qendrës menaxhuese sipas ligjit;
- Prerja e pyjeve, ndotja e ambientit, mungon ndarja që në burim e mbeturinave shtëpiake dhe komerciale, ripërdorimi, riciklimi dhe trajtimi adekuat i tyre në deponinë rajonale si dhe prania e deponive ilegale;
- Mungesa e trajtimit të ujërave të zeza familjare dhe veçanërisht industriale në Junik dhe ndotja e tokës dhe ujërave është faktor kërcënues për turizmin dhe mirëqenie në Junik;
- Trashëgimia natyrore e Junikut e pa njohur mjaftueshmërisht në Evropë dhe botë;
- Shtigje të pamjaftueshme të sinjalizuara dhe mirëmbajtura për ecje, çiklizëm, kalërim etj.;
- Mungesa e rezervateve të gjuetisë ndonëse fondi i gjahut konsiderohet i lartë (pa studim);
- Mungesa e evidentimit dhe hartëzimit të objekteve dhe hapësirave turistike, rekreative dhe pushimi;
- Mungesa e infrastrukturës për rekreacion dhe sporte verore dhe dimërore në Junik
- Mos definimi i planit hapësinor për zona të veçanta dhe zona të mbrojtura;

- Vetëdija e ulët për rolin dhe rëndësinë e turizmit si aktivitet relativisht i ri ekonomik dhe hezitimi për të akomoduar turistë në shtëpitë private;
- Shfrytëzimi jo efikas i mundësive të mëdha sidomos për turizmin në stinën e verës;
- Lëvizjet demografike si shpërngulja masive e banorëve veçanërisht nga zonat malore, si rezultat i shkatërrimit të ekonomive familjare nga lufta, për kushte jetësore, shkollim dhe punësim si dhe kthimi i ngadaltë i popullatës në këto zona;
- Masat institucionale, fondet dhe kapacitetet njerëzore për zhvillimin e turizmit në Junik janë përgjithësisht të kufizuara dhe niveli ndryshon;
- Mos definimi adekuat dhe mungesa e zhvillimit të produktit turistik karakteristik;
- Mos njohja e përparësive dhe investime adekuate në sektorin e turizmit përfshi atë konferencier;
- Infrastruktura dhe disa shërbime publike si mbeturinat jo të kënaqshme dhe koherente;
- Mungesa e mirëmbajtjes së rrugëve që nuk mbulohen nga shërbimet komunale;
- Çështjet e titullarit pronësor, përdorimit dhe menaxhimit të tokës;
- Mos definimi dhe harmonizimi i veprimeve dhe kompetencave institucionale;

## Parime për turizmin e qëndrueshëm

Një sërë parimesh për një turizëm të qëndrueshëm natyror në harmoni dhe në funksion të natyrës, si në një park në Japoni, të aplikueshme për turizmin në Rajonin perëndimor janë:

- Vlerat natyrore janë të ruajtura dhe konservimi i natyrës promovohet;
- Sa më pak që të jetë e mundur presion (ndikim) në mjedis;
- Traditat dhe kulturat lokale respektohen;
- Vizitorët e rrisin të kuptuarit dhe vlerësimin për natyrën dhe kulturën;
- Infrastruktura e përmirësuar iu ofrohet në përdorim vizitorëve;
- Vizitorët inkurajohen të shijojnë rekreacionin mental dhe fizik;
- Ekonomia, produktet dhe punësimi lokal promovohen;
- Materialet promovuese përgatiten dhe publikohen me kujdes dhe përgjegjësi;
- Aktivitetet turistike janë të planifikuara dhe organizuara në bashkëpunim si dhe
- Përcaktimi i treguesve dhe monitorimi i zhvillimit të industrisë turistike dhe evitimi i tejkalimit të kapacitetit janë mbrojtës të natyrës.

## Vlerësim i gjendjes

### Analiza e profilit – Vlerësimi i gjendjes në komunë

Kjo analizë shqyrton ndikimin e çështjeve të hulumtuara të cilat, në formë të përparësive, dobësive, mundësive dhe rreziqeve (SWOT analizat), paraqesin faktorët kryesorë për zhvillimet e ardhshme.

#### Përparësitë:

- Gjendja fiziko-gjeografike:
- Pozita e mirë gjeografike me potencial natyror ende të pashfrytëzuar
- Prania e peisazheve ujore, fushore dhe malore (lumit Erenik, maja Gjevica, kullosat)
- Flore dhe faune te pasur

#### Gjendja socio-ekonomike:

- Karakteri vital dhe i paepur i popullsisë Junikase (popullsi e re dhe e aftë për punë)
- Nivel i lartë i sigurisë dhe respektit të ndërsjellë shoqëror
- Diasporë e fortë dhe përkrahëse e fuqishme e zhvillimeve
- Qasje e lehtë në shërbimet e shëndetësisë dhe arsimit o zhvillimi ekonomik
- potencial për zhvillimin e bujqësisë dhe agro-biznesit
- Potenciali pyjor
- Vetëdijesimi për zhvillim e bujqësisë dhe agro-biznesit
- Afërsia me zonat ku zhvillohet turizmi malor, historik kulturor
- Interesimi i madh i popullsisë për zhvillimin e turizmit
- Tradita në kultivimin e zejeve tradicionale (përpunimin e leshit, thurjes së rrobave tradicionale, qëndisjes)
- Nivel i kënaqshëm i bashkëpunimit mes sektorit publik-privat

#### Infrastruktura fizike dhe shërbimet publike:

- Qasje e lehtë në infrastrukturën rrugore Lidhjet e jashte rrugore (në rrugë regjionale) në gjendje relativisht të mirë
- Burime të mjaftueshme të ujit dhe furnizimi i mirë me ujë të pijes
- Shfrytëzimi i tokës/vendbanimet dhe banimi:
- Dendësia relativisht e ulët e ndërtimit në zonën urbane
- Shtrirje policentrike të lagjeve (sipas PZHU)
- Hapësira ende të lira për zhvillim të ardhshëm

#### Mjedisi:

- Peisazhet dhe zonat e rrezikuara nga ndotja, degradimi dhe fatkeqësitë natyrore
- Jo shumë ndërtime pranë shtratit të lumit
- Nuk ka aktivitete ndotëse industriale
- Prezencë e peisazheve lumore, malore, fushore
- Lloje relikte të florës dhe faunës me vlera shkencore dhe farmaceutike
- Resurse natyrore me potencial zhvillimi turistik Trashëgimia kulturore
- Interesim i lartë i qeverisë dhe banorëve për zhvillimin dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore
- Lokacion i njohur për trashëgimi kulturore:
- Kullat, mullinjtë, vajavicat
- Vend historik-Kuvendi i Junikut Sistemi i planifikimit hapësinor (aspekti organizativ)
- Staf i ri dhe i motivuar për njohuri të reja dhe avancim
- Përkrahje politike për të zhvilluar këtë sektor

### **Mundësitë:**

#### **Gjendja fiziko-gjeografike:**

- Ndërlidhja me shtetet fqinje

#### **Gjendja socio-ekonomike:**

- Burimet njerëzore, mosha e re e popullsisë dhe aktive në punë
- Projektet në realizim e sipër mundësi për të përmirësuar shërbimet në arsim dhe shëndetësi
- Përkushtimi i qeverisjes vendore në të gjitha nivelet për të prodhuar programe zhvillimi për Junikun dhe promovimin e tij në rajon e më gjerë është zhvillimi ekonomik
- Potencial për zhvillimin e bujqësisë dhe agrobiznesit si dhe ndërmarrjeve agro-përpunuese,
- Mundësi për ngritjen e pemishteve intensive - Sipërfaqet e punueshme dhe potencial i mjaftueshëm ujor për ujitjen e tokave
- Potencial për zhvillim të pylltarisë dhe blegtorisë
- Potencial për zhvillimin e energjisë alternative (hidrocentralet, biomasa, etj)
- Resurset natyrore dhe kulturore e historike potencial për zhvillimin e turizmit dhe hotelarisë Infrastruktura fizike dhe shërbimet publike
- Mundësi për kyçjen në rrugë regjionale dhe atyre me lidhje tejkuftare
- Mundësi e përfitimit nga projektet mbi bashkëpunimin ndërkomunal me Gjakovën e Deçanin
- Zhvillimi i infrastrukturës së këmbësorëve brenda dhe jashtë zonës urbane (ajo jashtë zonës urbane mund të shfrytëzohet edhe për sport, rekreacion për banorët, turistët vendor dhe ndërkombëtar),
- Mundësi e qasjes në transportin hekurudhor poqese zhvillohet linja hekurudhore Gjakovë-Klinë

- Mundësi komunikimi të shpejta përmes linjave ajrore poqese realizohet projekti i Aeroportit të Kukësit apo dhe ai i Gjakovës
- Mundësi e përmirësimit të furzinimit me ujë meqe ka burime ujore me potencial zhvillimit
- Mundësitë e shfrytëzimit të fondeve të donatorëve për shtrirjen e rrjetit të kanalizimit
- Mundësi e shfrytëzimit të fondeve për zhvillimin e studimeve për energji alternative
- Zgjerimi i rrjetit të telekomunikimit dhe internetit do të mundësojë komunikim më të shpejtë dhe qasje më të lehtë në informata
- Menaxhim më i mirë i mbeturinave me marrjen përsipër të kompetencave nga komuna për kryerjen e këtij shërbimi (sidomos të grumbullimit) Shfrytëzimi i tokës/vendbanimet dhe banimi
- Trajtimi i vendbanimeve të depopulluara, vendbanimit joformal dhe banimit mundësi e mirë për të përmirësuar jetën e qytetarëve të Junikut Mjedisit, peisazhet dhe zonat e rrezikuara nga ndotja, degradimi dhe fatkeqësitë natyrore
- Fuqizimi i kapaciteteve komunale për menaxhim të resurseve natyrore dhe rreziqeve nga fatkeqësitë
- Shfrytëzimi i programeve të ndryshme të donatorëve për mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e biodiversitetit Trashëgimia kulturore
- Ngritja e kapaciteteve humane dhe organizative komunale
- Bashkëpunim me donatorë rreth hartimit të planeve dhe projekteve të trashëgimisë
- Bashkëpunim ndërkomunal rreth zhvillimit dhe promovimit të trashëgimisë kulturore (inicimi i hartimit të planit hapësinor për Kullat e Dukagjinit) Sistemi i planifikimit hapësinor (aspekti organizativ)
- Fuqizimi i sektorit të planifikimit hapësinor dhe ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve të stafit.

## Çështjet për trajtim

Analiza e situatës nxjerr këto përfundime duke vënë në pah çështjet prioritare të cilat duhet adresuar për periudhën për të cilën hartohet Plani. - Pozita gjeografike, resurset natyrore që spikatin Junikun (sidomos maja më e lartë Gjeravica) si dhe potenciali kulturor duhet shfrytëzuar në favor të zhvillimit ekonomik. - Popullsia junikase karakterizohet me një shkallë të mesme të varfërisë dhe sikurse e gjithë popullsia e Kosovës, nivel shumë të lartë të papunësisë. Popullsia është shumë e re dhe aktive për punë. Nëse nuk krijohen kushte për zhvillim ekonomik dhe mundësi punësimi, situata e tillë do të keqësohet edhe më tej dhe kjo do të rriste edhe më tej dëshirën e të rinjve për të migruar në kërkim të kushteve më të mira për jetesë dhe në skenarion më të keq edhe paraqitjen e dukurive negative të shoqërisë. Zhvillimi ekonomik është në shkallë të ulët. Kjo nga njëra anë mund të arsyetohet se Juniku tash së voni është shpallur komunë, megjithatë pavarësisht kësaj junikasit kanë patur traditë të zhvillimit të disa sektorëve të caktuar të ekonomisë (bujqësisë, blegtorisë etj) në të kaluarën. Analiza e gjendjes së zhvillimit të këtij sektori ka vënë në pah katër shtylla mbi të cilat mund të bazohet zhvillimi ekonomik: Turizimi i bazuar në natyrë dhe ai kulturor; bujqësia përfshirë blegtorinë; pylltaria dhe energjia alternative. Ky zhvillim kryesisht bazohet në potencialin dhe resurset natyrore, por pavarësisht kësaj vlerëson

edhe zhvillimin e sektorëve tjerë shërbyes dhe infrastrukturës përcjellëse që mbështesin këta sektorë. - Marrë parasysh që Juniku ishte një vendbanim rural, natyrisht që edhe infrastruktura fizike dhe qasja në shërbimet publike i përkasin karakterit rural dhe janë ende të pakompletuara. Me ndryshimin e statusit dhe shpalljen e Junikut komunë, kjo infrastruktura si dhe shërbimet publike kanë nevojë për përmirësim. Është vlerësuar si e rëndësishme sigurimi i qasjes në beshkë dhe ngritja e infrastrukturës së këmbësorëve në këtë zonë. Kjo për arsye se vlerësohet se nuk mund të ketë një zhvillim të mirëfilltë të turizmit poqese nuk trajtohet edhe problemi i arritshmërisë së lehtë në këtë zonë i turistëve (vëndorë apo ndërkombëtarë) apo edhe shfrytëzuesve të cilët shfrytëzojnë potencialin sportiv e rekreativ të zonës. - Analiza ka vlerësuar se është me rëndësi që vendbanimet të kenë një trajtim adekuat. Trajtimi i vendbanimit joformal duhet të lidhet ngusht me trajtimin e vendbanimeve Jasiq dhe Gjocaj të cilat janë në depopullim e sipër. Kësaj problematike i shtohet edhe aspekti i sigurisë për shkak të prezencës së minave. Çështja e banimit dhe ndërtimeve është elaboruar detajisht në PZHU ndaj vlerësohet se PZHK duhet t'i referohet zhvillimeve të PZHU-së në këtë lëmi. - Ndotja e ujit dhe e tokës nga mbeturinat dhe derdhja e ujërave të zeza janë çështje brengosëse ashtu siç është edhe prezenca e dukurive negative (prerja e pyjeve, zjarret, nxjerrja e zhavorit, veprimet e gurthyesve) dhe fatkeqësive natyrore (tërmetet, vërshimet, ...) të cilat sjellin pasoja për jetën e banorëve dhe rrezikimin e biodiversitetit. Nga ana tjetër, vlerësohet se ekzistojnë mundësi të shumta përfshirë edhe programe të ndryshme donatorësh, për të përmirësuar gjendjen mjedisore, ruajtjen e resurseve dhe biodiversitetit. - Është evidentuar që trashëgimia kulturore po shkaktohet nga viti në vit. Veprimet për mbrojtjen dhe zhvillimin e këtij resursi kërkojnë buxhet shumë të madh. Buxheti i komunës nuk mund t'i përballojë kostot e mëdha të restaurimit ndaj dhe si mundësi pothuajse e vetme shihet bashkëpunimi me donatorë që ofrojnë programe dhe projekte investive në fushën e trashëgimisë. - Një Plan nuk është strategjik, poqese nuk adreson edhe aspektin institucional. Si Komunë e re dhe në konsolidim e sipër, ka nevojë për zhvillimin e mirëfilltë të Sektorit për Planifikim Hapësinor (i cili do të jetë bartësi kryesor i zbatimit të Planit) duke adresuar vazhdimisht nevojën për ngritjen e kapaciteteve sidomos atyre humane në këtë lëmi.

### **Zhvillimi i qëndrueshëm**

Përdorimi i të gjitha burimeve duhet të plotësojë nevojat e njerëzve në ditët e sotme, duke mbrojtur mjedisin në atë mënyrë që gjeneratat e ardhshme të mund t'i plotësojnë nevojat e tyre në një të ardhme të pa definuar. Kjo përfshin të gjitha zhvillimet ekonomike, sociale dhe mjedisore, si dhe mbrojtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

### **Zhvillimi i barabartë**

Për të gjitha pjesët e qytetit dhe për të gjitha grupet e popullsisë duhet të sigurohen mundësi të barabarta dhe përparësi për të gjitha zhvillimet.